

---

## KONTRATË SHITJE KUOTASH

Sot më datë **07.04.2022**, bazuar në nenin 73/1/b të Ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" – i ndryshuar, nenin 705 dhe vijues të ligjit nr. 7850 dt. 29.7.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" dhe statutin e shoqërisë "**LA STRADA**" **SHPK**, nënshkruhet kjo "kontratë për shitje kuotash" si më poshtë vijon:

### Neni 1

#### Palët kontraktuese

- 1) Shoqëria "**INTER MEDIA GROUP**" **SHPK**, me Nr. NUIS L61429018R, nga këtu e më poshtë referuar si "**Shitësi**", përfaqësuar në këtë kontratë nga Ortaku dhe Administratori i Vetëm z. Theodhoro Çami, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë, më datë 06.09.1981, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me numër I10906013F;

dhe

- 2) **Z. Vasil Mero**, shtetas Shqiptar, lindur në Gjirokastrë, më datë 25.03.1952, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal F20325020R, nga këtu e më poshtë referuar si "**Blerësi**".

### Neni 2

#### Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është shitja prej Shitësit kundrejt Blerësit të **1 (një) kuote** të kapitalit të shoqërisë "**LA STRADA**" **SHPK (NUIS K91511005Q)**, e cila përfaqëson **100% (njëqind përqind)** të kapitalit të shoqërisë.

### Neni 3

#### Çmimi i shitjes

Çmimi total i shitjes që do t'i paguhet Shitësit nga Blerësi, është vlera nominale e kuotës ose **79.185.147 lekë**.

### Neni 4

#### Mënyra e pagesës dhe kalimi i pronësisë

4.1. Çmimi i shitjes i përcaktuar në nenin 3 të kësaj kontrate, do të paguhet prej Blerësit, brenda një afati kohor 10 (dhjetë) vjeçar duke filluar nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

---



4.2. Palët nëpërmjet një marrëveshje të veçantë me shkrim, mund të vendosin modalitete të tjera lidhur me pagesën e çmimit të cituar në këtë kontratë.

4.3. Pavarësisht sa më sipër, me nënshkrimin e kësaj kontrate prej palëve, Blerësi fiton pronësinë e plotë mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate, duke u shndërruar edhe në Ortak të Vetëm, zotëruesin e vetëm të kuotës (kapitalit) të shoqërisë "LA STRADA" SHPK.

## **Neni 5**

### **Detyrimet e shitësit**

5.1. Shitësi do të pranojë çmimin e shitjes, të parashikuar në Nenin 3, si çmimin e plotë dhe përfundimtar të shitjes së kuotës (kapitalit) objekt të kësaj kontrate, që ai kishte në shoqërinë "LA STRADA" SHPK, kuotë (kapital) që menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalon Blerësit.

5.2. Shitësi garanton se kuota objekt i kësaj kontrate, nuk është lënë peng, në dorëzani apo rënduar me ndonjë lloj tjetër barre dhe se ai është i vetmi pronar e gëzon të drejta të plota mbi të.

5.3. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitësi heq dorë nga të drejtat që ai kishte mbi kuotën (kapitalin) objekt të kësaj kontrate.

## **Neni 6**

### **Detyrimet e Blerësit**

Blerësi merr përsipër të paguajë çmimin e shitjes, sipas mënyrës së parashikuar në nenin 4 të kësaj kontrate.

## **Neni 7**

### **Gjuha e Kontratës dhe hyrja në fuqi**

Kjo kontratë përgatitet në 2 kopje, të dyja të njëvlershme dhe origjinale. Secila prej palëve në këtë kontratë do të marrë një kopje të kontratës. Kjo kontratë hyn në fuqi sot më datë **07.04.2022.**

#### **SHITËSI**

**Inter Media Group SHPK**

**Z. Theodhoro Çami**

*Theodhoro Çami*  
**INTER MEDIA GROUP Sh.p.k**  
**NUIS: L61429018R**  
Tiranë

#### **BLERËSI**

**Z. Vasil Mero**

*Vasil Mero*  
**La Strada sh.p.k.**  
Dr. Them...  
Tiranë  
**NUIS: K01511005Q**